



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:160916
Datë: 03.05.2024
Numri i dokumentit: 05654376

CA.nr.4186/24

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli - kryetare e kolegjit, Ardian Ajvazi dhe Ylber Shurdhiqi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të propozueses së sigurimit S.F. nga Gjakova, rr. “....” pn., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.R., avokat në Gjakovë, kundër kundërshtarit të sigurimit Sh. K. nga Gjakova, rr. “....” pn., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson P.K., avokat në Gjakovë, për caktimin e masës së sigurimit, duke vendosur lidhur me ankesën e kundërshtarit të sigurimit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm, 2023:160916, datë 29.01.2024, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datën 29.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kundërshtarit të sigurimit Sh.K. nga Gjakova, rr. “....” pn., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm, 2023:160916, i datës 29.01.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar, 2023:160916, i datës 29.01.2024, në pikën I, të dispozitivit ka vendosur që të: Aprovohet propozimi për caktimin e masës së sigurimit, i paraqitur nga propozuesja e sigurimit S.F. nga Gjakova ashtu që Caktohet masa e sigurimit dhe i Ndalohe kundërshtarit të sigurimit SH.F. nga Gjakova, që të bëjë ndryshimin e gjendjes ekzistuese, përkatësisht të ndërtoj dhe të vazhdoj punët ndërtimore, të bartë në posedim të personat e tretë paluajtshmerinë, e cila evidentohet si ngastër kadastrale P-.... me lloj të shfrytëzimit: tokë ndërtimore, më shfrytëzim aktual oborr në sipërfaqe prej 217 m2 dhe shtëpi - ndërtesë në sipërfaqe prej 34 m2, e në sipërfaqe të përgjithshme prej 251 m2, Zona Kadastrale

..., pjesë e pronës 1/1, deri në ndonjë vendim tjetër të kësaj gjykate. Në pikën II, të dispozitivit ka vendosur: Ky aktvendim t'i dërgohet edhe Stacionit Policor në Gjakovë, Drejtorisë për Punë Inspektuese, si dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunën e Gjakovës. Në pikën III, të dispozitivit ka vendosur: Detyrohet propozuesja e sigurimit që në afatin prej 45 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi të ngrit padi e cila do të sigurohet me këtë masë të sigurimit.

Kundër këtij aktvendimi i autorizuari i kundërshtarit të sigurimit në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktvendimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe propozimi për caktimin e masës së sigurisë të refuzohet si i pabazuar, apo aktvendimi të anulohet dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe vendosje.

Me përgjigje në ankesë i autorizuari i propozueses së sigurimit i ka kontestuar në tërësi të pabazuara pretendimet ankimore të kundërshtarit të sigurimit, me propozim që ankesa të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktvendimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e kundërshtarit të sigurimit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se propozuesja e sigurimit, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 26.07.2023, në gjykatën e shkallës së parë kundër kundërshtarit të sigurimit ka paraqitur propozim për caktimin e masës së sigurimit, me arsye dhe kërkesë si në propozim.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas propozimit, për vlerësimin e masës së sigurisë ka caktuar seancën dëgjimore. Pas vlerësimit të deklarimeve të palëve në procedurë dhe mbi bazën e provave shkresore ka gjetur se propozimi është i bazuar, prandaj të njëjtin e aprovoi duke vendosur si në dispozitivin e aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka ardhur në përfundim se propozuesja e masës së sigurimit e ka bërë të besueshme të drejtën e saj subjektive, pasi që nga provat e bashkëngjitura dhe të nxjerra përgjatë shqyrtimit gjyqësor është provuar se propozuesja e masës së sigurimit evidentohet si pronare e paluajtshmërisë lëndore, e me këtë ekziston edhe interesi i saj në kuptimin material të çështjes, e rrjedhimisht edhe besueshmëria e kërkesës apo e të drejtës së saj subjektive, siç parashihet edhe me nenin 297 paragrafi 1 pika a) të LPK-së. Tutje, kjo gjykatë vlerëson se nga parashtrimet e palëve dhe provat e nxjerra përgjatë këtij shqyrtimi, plotësohet edhe kushti i dytë, i paraparë me nenin 297 paragrafi 1, pika b) të LPK-së, pasi që propozuesja e masës së sigurimit e ka provuar faktin se ekziston rreziku që pa caktimin e masës së sigurisë do të vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesës nga ana e palës kundërshtare e sigurimit, pasi që kundërshtari i sigurimit në parcelën objekt lëndor ka filluar ndërtimin e objektit të banimit të përshkruar si në ekspertizën e gjeodezisë, për të cilin objekt janë ndërprerë punimet sipas organeve komunale inspektuese. Andaj, gjykata ka vlerësuar se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë, kundërshtari i sigurimit do të mund t'a pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës së propozueses së sigurimit, sidomos me ndryshimin e gjendjes ekzistuese apo edhe dorëzimin në posedim të personat e tretë të paluajtshmërisë e cila evidentohet si ngastër kadastrale P-....me lloj të shfrytëzimit: tokë ndërtimore, me shfrytëzim aktual: oborr në sipërfaqe prej 217 m² dhe shtëpi - ndërtesë në sipërfaqe prej 34 m², e në sipërfaqe të përgjithshme prej 251 m², Zona Kadastrale pjesë e

pronës 1/1, deri në ndonjë vendim tjetër të kësaj gjykate për këtë çështje juridike. Gjykata ka ardhur në përfundim se me ndonjë veprim tjetër apo me mosveprim në këtë fazë të procedurës do të rrezikohet shkaktimi i ndonjë dëmi të pakompensueshëm për propozuesen, me çka do të humbej qëllimi dhe kuptimi i kësaj mase, prandaj në kuptim të nenit 297 paragrafi 1 pika a) dhe b) paragrafi 2 dhe 3 i tij, si dhe nenit 300 pika 1 nën a) si dhe 301 pika 1 nën a) të LPK-së, aprovoi propozimin për caktimin e masës së sigurisë, duke shtuar faktin se propozuesja e masës së sigurimit e ka plotësuar edhe kushtin e tretë për caktimin e masës së sigurimit të paraparë me nenin 297 paragrafi 2 dhe 3 të LPK-së, duke dhënë garancinë e caktuar nga gjykata në shumë prej 3,000.00 euro.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ju ka referuar nenit 297 paragraf 1 pika a) dhe b), paragraf 2 dhe 3, 300 paragraf 1, 301 paragraf 1, pika a) dhe b) dhe 304 paragraf 3 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar me ankesë nuk është i përfshirë në shkëlqje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat Gjykata e Apelit, në kuptim të nenit 194 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të kundërshtarit të masës së sigurimit se aktvendimi i atakuar është marrë me shkëlqje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktvendimi i atakuar është i qartë si në pjesën e dispozitivit dhe atë të arsyetimit dhe se gjykata e shkallës së parë ka dhënë edhe arsye të mjaftueshme rreth mënyrës së vendosjes dhe fakteve vendimtare. Një mënyrë e tillë e vendosjes sipas vlerësimit të gjykatës ankimore ka mbështetje në provat nga shkresat e lëndës dhe në ligj dhe se aktvendimi i atakuar përmban të gjitha elementet ligjore të parapara me dispozitivin e nenit 160 e lidhur me nenin 175 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat përkatësisht faktet e çështjes, mbi bazën e të cilave ka ardhur në përfundim se propozimi për caktim të masës së sigurimit të kërkesëpadisë është në tërësi i bazuar.

Gjykata e Apelit e ka pranuar përfundimin e gjykimit të shkallës së parë për aprovimin e propozimit për caktimin e masës së sigurimit të kërkesëpadisë, për faktin se propozuesja e sigurimit ka arritur ta bëjë të besueshme ekzistimin e të drejtës subjektive dhe ekzistimin e rrezikut se pa caktimin e masës së sigurimit, dukshëm do të vështirësohet apo pamundësohet realizimi i kërkesës sipas çëhtjes kryesore, për të cilën propozuesja është obliguar të inicioj procedurën kontestimore. Sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, neni 297 paragrafi 1 pika a) dhe b), përcaktohet se masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtën subjektive të tij, në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund të pamundësohet apo vështirësohet dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjerave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit, por që këto dy kushte duhet të plotësohen në mënyrë kumulative.

Me nenin 304 paragraf 3 të LPK-së, përcaktohet se: “ Në propozimin për caktimin e masave të sigurimit propozuesi i sigurimit duhet ta tregojë në të kërkesën, për sigurimin e të cilës bënë propozim, masën e sigurimit që e propozon, mjetet dhe objektin e masës së sigurimit. Në propozim duhet të tregohen edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia, si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në

propozim. Propozuesi i sigurimit ka për detyrë po që se ka mundësi, që mjetet provuese t'ia bashkëngjitë propozimit ”.

Në këtë rast, sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë, në bazë të provave dhe shkresave të lëndës, rezulton se e drejta subjektive e propozueses është vërtetuar mbi bazën e provave materiale përkatësisht nga certifikata pronësore, nga e cila provë rezulton se propozuesja është pronare e paluajtshmërisë lëndore në 1/1 pjesë, ndërsa ekzistimi i rrezikut është vlerësuar mbi bazën e gjendjes faktike në terren dhe nga ekspertiza e gjeodezisë, ku konstatohet se në paluajtshmërinë lëndore, kundërshtari i sigurimit ka ndërmarrë veprime me ndërtimin e objektit, pa ndonjë bazë ligjore në paluajtshmërinë - pronë e propozueses. Në këtë kuptim, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se masa e sigurimit të kërkesëpadisë, çdoherë duhet të shërben për ruajtjen e një gjendje ekzistuese të gjerave, me ndryshimin e të cilave palës e cila ka propozuar caktimin e saj, do t'i shkaktohej dëm i riparueshëm dhe i pa kompensueshëm ose do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit, për çka në këtë rast duke marr për bazë të gjeturat nga gjykata e shkallës së parë, duke mos përjashtuar edhe provat tjera prezent në shkresat e lëndës, është vlerësuar edhe i kësaj gjykate se aprovimi i propozimit, për caktimin e masës të sigurimit sipas aktvendimit të atakuar, është vendim i drejtë dhe ka mbështetje në ligj.

Sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit, masa e sigurimit, e caktuar sipas aktvendimit të atakuar nuk do të ketë asnjë efekt negativ tek pala kundërshtare, aq më tepër kur nga propozuesi në depozitën e gjykatës se shkallës së parë ka deponuar garancioni, për sigurimin e dëmit eventual të cilin kundërshtari i masës së sigurimit do të mund të pësonte, si shkak i caktimit të masës sigurorese, por edhe zbatimit të saj eventual.

Përveç kësaj, caktimi i masës së sigurimit ka karakter të përkohshëm, pasi që gjykata e shkallës së parë, gjatë procedurës, nuk ka pengesa ligjore që masën e sigurimit të kërkesëpadisë, ta revokoj në qoftë se e njëjta në ndërkohë vlerëson se kanë ndryshuar, përkatësisht pushuar rrethanat për të cilat është caktuar, apo të njëjtën ta zëvendësoj duke shqiptuar lloj tjetër të masës, e cila sa me pak do të prekte të drejtat dhe interesat e palëve në procedurë.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar të gjitha pretendimet e tjera ankimore, por nuk ka gjetur se ekzistojnë rrethana apo shkelje të tilla që do të ndikonin për nxjerrjen e një vendimi ndryshe, për çka edhe vendosi si dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga arsyet e parashtruara më sipër dhe në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 pika b) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CA.nr.4186/24, me datë 29.04.2024

Kryetare e kolegjit
Hunaida Pasuli